



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës i Rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës që të kërkoj nga Agjencia Kosovare e Privatizimit si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) zbatimin e Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, C. Nr. 340/2001, të datës 11 janarit 2002.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka, do të kryejë të gjitha obligimet që dalin nga Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të datës 17 dhjetorit 2010 (Nr. Ref. AGJ 75/10).
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia dërgoj për shqyrtim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 90 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, Ligjit nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Projekt-marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.
2. Projekt-marrëveshja nga pika 1. e këtij vendimi do të nënshkruhet në pajtim me nenin 90 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Ndryshohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë nr. 01/176 i datës 10 mars 2014 si në vijim:

“1. Rriten pagat për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagat nga buxheti i Republikës së Kosovës në nivelin 25% në pagën bazë nga data 1 prill 2014, me përjashtim të Zyrtarëve të lartë publik me mandat politik duke përfshirë këtu pozitën e Presidentit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrave, Ministrave, Zëvendësministrave, Kryetarit të Kuvendit, Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të gjithë këshilltarëve politik dhe pozitave të ngjashme me mandat politik, dhe personelit tjetër politik në nivelin e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës. Vendimi për rritjen e pagave nuk përfshinë pozitën e zyrtarëve publik paga e të cilëve me ligj është rregulluar duke u bazuar në nivelin e pagës së Kryeministrit, Ministrave, si dhe zyrtarëve të tjerë të lartë politik të përjashtuar nga rritja përmes këtij Vendimi. Nga rritja e pagave përjashtohet edhe shërbimi i jashtëm i Republikës së Kosovës.”

2. Mjetet e parapara për rritjen e pagave të zyrtarëve të lartë publik të përjashtuar nga rritja e pagave sipas këtij Vendimi, përmes procesit të rishikimit të buxhetit do të destinohen për krijimin e programit (nën-programit) të veçantë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, për shërimin e fëmijëve të sëmurë nga kanceri, leukemia dhe sëmundjet tjera të ngjashme.
3. Obligohet Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në pajtim me konkluzionet e takimit të përbashkët të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës të mbajtur në Prizren më 11 janar 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) euro për bashkëfinancimin e ndërtimit të Maternitetit në Preshevë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga programi - Shpenzimet e paparashikuara (kodi 232-180), kategoria ekonomike Rezerva dhe transferohen në Ministrinë e Financave, Departamenti i Thesarit, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave që mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ti bartë në llogarinë e Komunës së Preshevës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/177


Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe neni 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 14 mars 2014 mori:

V E N D I M - P R E L I M I N A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Segmentit Rrugor 7.3 që lidhë Autostradën Vërmicë-Merdare R7, Autoudhën R6 Prishtinë-Hani i Elezit dhe Rrugën Magjistrale M2, Zona Kadastrale, Qagllavicë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkuar dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ministria e Infrastrukturës.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/177


Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim të përhershëm dhe me krijimin e të drejtës së servitutit për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Linjës 400kV Kosovë-Shqipëri, Segmenti I-parë 16 km, Zonat Kadastrale Obiliq dhe Plemetin, të Komunës Obiliq, Zonat Kadastrale Prilluzhe, Bivolak, Strofc dhe Zhilivode të Komunës së Vushtrrisë dhe Zonat Kadastrale Gradicë dhe Gllanasellë, Komuna Drenas, sipas tabelave të bashkangjitura këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 dhe Udhëzimin Administrativ nr.13/2011 për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.).
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit do ti sigurojë Subjekti Kërkues, Kompania KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh. A.).

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe neni 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe neni 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe neni 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 14 mars 2014 mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi dhe vlerësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Objektivit të Agjencisë Kosovare të Forenzikës /Ministria e Punëve të Brendshme, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna e Prishtinës, sipas tabelës të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilitdo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo

person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Z. Eset Rama, emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAQI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/177

Datë: 14.03.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 mars 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shtesa në pagë për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës për vitin 2014 në shumë 209,000.00 (dyqindenëntë mijë) euro.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në OB 250 Prokurori Shtetit, Programi 322 Prokuroria Speciale.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë